



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:146884  
Datë: 19.04.2022  
Numri i dokumentit: 02930449

C. nr. 1011/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Gllogjani dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, në çështjen juridike të paditëses E.E.D. nga Gjakova, përfaqësuar nga Ylli Bokshi avokat nga Gjakova kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria Komunale e Arsimit, kontest pune - kompensim të ushqimit dhe udhëtimit, vlera kontestit 1,510.48 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 10 mars 2022, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të paditurës, përpiluar me datë 19 prill 2022, murr këtë:

A K T G J Y K I M

DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës- Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses E.E.D. nga Gjakova, për periudhën kohore 01 shtator 2015 deri më 31 maj 2021 të i kompensoj: -në emër të shpenzimeve për ushqim në vendin e punës shumën prej 518.00euro, -në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në punë shumën prej 992,48 euro, në shumën e përgjithshme prej 1,510.48 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 359.20 euro të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja me padi, parashtresë dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të saj ka parashtruar se është e punësuar si mësimdhënëse në Shkollën “Pjetër Muqaj “ në fshatin Guskë, komuna e Gjakovës, tek e paditura Drejtoria Komunale Arsimit në Gjakovë.

Paditësja punon një ditë të javës në SHFMU “Dy Dëshmorët” në Sheremet, komuna e Gjakovës, një ditë të javës në SHFMU “Ardhmëria” në . . . , komuna e Gjakovës, një ditë të javës në SHFMU ”Ganimete Terbeshi” në Ponoshec, komuna e Gjakovës dhe një ditë të javës në SHFMU ”Pjetër Muqaj” në Guskë, komuna e Gjakovës.

E paditura, në bazë të nenit 36 paragrafi 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit nënshkruar mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK me datë 18 prill 2017, obligohet që punëtorëve të arsimit, përkatësisht edhe këtu paditëses E.E.D. të i kompensoj ushqimin gjatë orarit të punës dhe atë 2.00 euro për çdo ditë të paraqitur në punë dhe 70% të çmimit të biletës së trafikut urban për udhëtim për destinacionin nga vendbanimi i paditëses deri në vendin e punës.

Për kundër detyrimeve të cilat e paditura ka konform Kontratave Kolektive të lartcekura, e paditura nuk ka përmbush obligimet e saja, për kompensimin e paditësës për ushqim gjatë punës dhe shpenzimet e udhëtimit.

Paditësja nga data 01 janar 2015 deri më 31 maj 2021 ka punuar 1019 ditë të pranisë në punë. Paditësja në procedurë administrative ka realizuar një pjesë të borxhit ashtu që paditësës në bazë të Vendimit të MPMS-Inspektoratit të Punës, nr. 1284/2020 të datës 05 nëntor 2020, paditësës në emër të shujtave i janë paguar 1,108.00 euro, për 554 ditë të pranisë në punë. Paditësës nuk i është kompensuar ushqimi në punë për gjithsejtë 465 ditë pune, ashtu që duke pas parasysh që e paditura ka obligim të paguaj nga 2.00 euro për çdo ditë të paraqitjes në punë, i bie që paditësës në emër të kompensimit të pagesës për ushqim në punë i ka borxh shumë prej 930.00 euro.

Paditësja për vajtje –ardhje në punë udhëton në SHFMU “Dy Dëshmorët” në Sheremet, komuna e Gjakovës, një ditë të javës në SHFMU ”Ardhmëria” në Ramoc, komuna e Gjakovës, një ditë të javës në SHFMU ”Ganimete Terbeshi” në Ponoshec, komuna e Gjakovës dhe një ditë të javës në SHFMU “Pjetër Muqaj” në Guskë, komuna e Gjakovës.

Bileta e trafikut urban në këto drejtime është :

Gjakovë - Sheremet kushton 1.30 euro, paditësja për vajtje ardhje paguan 2.60 euro, 70% e kësaj shume rezulton të jetë 1.82 euro.

Gjakovë-Ramoc kushton 0.70euro, paditësja për vajtje ardhje paguan 1.40 euro, 70% e kësaj shume rezulton të jetë 0.98 euro.

Gjakovë-Guskë kushton 0.50 euro, paditësja për vajtje ardhje paguan 1.00 euro, 70% e kësaj shume rezulton të jetë 0.70 euro

Gjakovë-Ponoshec kushton 1.30 euro, paditësja për vajtje ardhje paguan 2.60 euro, 70% e kësaj shume rezulton të jetë 1.82 euro.

Pasi që paditësja ka punuar në katër shkolla dhe ka udhëtuar dhe paditësës nuk i është bërë pagesa e shujtave, duke vërtetuar se tek Inspektorati i Punës sipas vendimit të lartë cekur si dhe është vendosur sipas asaj ankese ka propozuar të caktohet ekspertizë financiare dhe të përcaktohet nga cila datë gjegjësisht periudhë paditësja nuk është kompensuar nga e paditura deri më datën 31 maj 2021. Duke pasur parasysh që paditësja në procedurë administrative sipas vendimit të Inspektoratit të Punës të MPMS, paditësës i është kompensuar një pjesë e shpenzimeve të ushqimit respektivisht shuma 1,108.00 euro, e paditura ka për obligim që paditësës të i kompensojë shumë prej 518.00 euro deri më 31 maj 2021. Sa i përket kriterit të udhëtimit e paditura ka për obligim që paditësës të i kompensojë 70% të atyre shpenzimeve dhe atë shumë prej 992.48 euro, dhe ka bërë precizimin e kërkesëpadisë. Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësës ka deklaruar se në bazë të provave të administruara është vërtetuar se e paditura ka pas për obligim që paditësës të i paguajë shpenzimet e ushqimit për nga 2.00 euro për secilën ditë të pranisë në punë dhe shpenzimet e udhëtimit 70% të çmimit të biletës së udhëtimit të cilat janë vërtetuar dhe me ekspertizën e ekspertit financiar. Andaj me provat e administruara dhe duke pasur parasysh që e paditura nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e njëjta është vërtetuar si përkah baza dhe lartësia. Propozoj që kërkesëpadia e precizuar të aprovet si e bazuar.

Shpenzimet procedurale i kërkoj për taksë gjyqësore shumë 20.00 euro, për përpilim të padisë shumë 104.00 euro, shumë 135.00euro për pjesëmarrje në seancë dhe ekspertizë financiare shumë 100.00euro, në shumë të tërësishme 359.00 euro.

E paditura nuk ka paraqit përgjigje në padi, të njëjtës i është proceduar Aktvendimi C.nr. 1011/21 datë 08 korrik 2021 për të dhënë përgjigje në padi, padia dhe provat, të pranuar nga e paditura me datë 13 korrik 2021 e paditura edhe përkundër detyrimit ligjor nuk është përgjigjur.

Shqyrtimin kryesor të treguar me datë 10 mars 2022 Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt, me propozimin e të autorizuarit të paditëses bazuar në nenin 423.4 të LPK-së.

Për të vendosur në këtë çështje juridike gjykata bëri administrimin e provave si: Kontratave të Punës datë 01 shtator 2015 deri më 31 gusht 2016, Leg.nr.2375/2021 datë 30 qershor 2021 dhe 01 shtator 2016, Leg.nr. 2376/21 datë 30 qershor 2021, vërtetimit të SHFMU "Pjetër Muqaj" Guskë nr.118 datë 30 qershor 2021, Certifikatës së vendbanimit nr. B . . . datë 24 shkurt 2021, vërtetimit nr. 1284/2020 datë 05 nëntor 2020, vërtetimit të Shoqatës së Transportit të Udhëtarëve Gjakovë pa datë dhe ekspertizës financiare të ekspertit Nd. N. ekonomist i diplomuar datë 28 janar 2022 ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesë padia e precizuar e paditëses është e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Sipas Kontratës së Punës datë 01 shtator 2015 deri më datë 31 gusht 2016 paditësja në cilësi të mësimdhënëses së lëndës së edukatës muzikore në Shkollën "Pjetër Muqaj" Guske ka lidhur kontratë pune me punëdhënësen këtu të paditurën me 40 orë pune në javë. Ka pasuar Kontrata tjetër e punës po ashtu me 40 orë punë në javë, për lëndën e njëjtë, në shkollën e njëjtë me orë të njëjta pune në javë prej datës 01 shtator 2016 në kohëzgjatje të përhershme.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Pjetër Muqaj" Guskë, komuna e Gjakovës nr. 118 datë 30 qershor 2021 provohet fakti se paditësja e punësuar si mësimdhënëse në atë shkollë gjatë viteve në vijim ka punuar:

- vitin shkollor 2014/2015 nga data 01 janar 2015 deri në përfundim të vitit shkollor ka vijuar 112 ditë të pranisë në punë;
- vitin shkollor 2015/2016 ka vijuar 184 ditë të pranisë në punë;
- vitin shkollor 2016/2017 ka vijuar 184 ditë të pranisë në punë;
- vitin shkollor 2017/2018 ka vijuar 116 ditë të pranisë në punë;
- vitin shkollor 2018/ 2019 ka vijuar 175 ditë të pranisë në punë;
- vitin shkollor 2019/2020 ka vijuar 100 ditë të pranisë në punë ndërsa për vitin shkollor 2020/2021 deri më 31 maj 2021 ka vijuar 148 ditë të pranisë në punë, gjithsejtë 1019 ditë të pranisë në punë.

Mësimdhënësja punon nga një ditë të javës në SHFMU "Dy Dëshmorët" në Sheremet, në SHFMU "Ardhmëria" në Ramoc, në SHFMU "Ganimete Tërbeshi" në Ponoshec dhe në SHFMU "Pjetër Muqaj" në Guskë, e që të gjitha këto shkolla në Komunën e Gjakovës.

Sipas Certifikatës së vendbanimit Nr. ser. B . . të datës 24 shkurt 2021 provohet rrethana se vendbanimi i paditëses është në Gjakovë, rruga ". . .

Nga vërtetimi i Shoqatës së Transportit të Udhëtarëve Gjakovë pa datë vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionet në vijim është :

- 1.Gjakovë- Sheremet 1.30 euro në një drejtim.
- 2.Gjakovë-Ramoc 0.70 euro në një drejtim .
- 3.Gjakovë- Guskë 0.50 euro në një drejtim.
- 4.Gjakovë- Ponoshec 1.30 euro në një drejtim.

Eksperti financiar Nd. N. me ekspertimin e formës së shkruar të datës 28 janar 2022 ka konstatuar se sipas Vendimit të MPMS-Inspektoratit të Punës nr. 1284/2020 të datës 05 nëntor 2020

paditëses i është kompensuar në emër të shujtave shuma prej 1,108.00euro për 554 ditë për periudhën me fillim nga data 01 shtator 2015.

Bazuar në vërtetimet e shkollave “Dy Dëshmorët” në Sheremet, SHFMU “Ardhmëria “Ramoc, SHFMU ”Ganimete Terbeshi” Ponoshec dhe SHFMU ”Pjetër Muqaj” Guskë paditësja ka këto ditë të pranisë në punë”

1. Në Shkollën “Dy Dëshmorët” në Sheremet 176 ditë pune x 2.00 euro =352euro,
2. Në Shkollën “Ardhmëria” Ramoc 207 ditë pune x 2.00= 414euro,
3. Në Shkollën Ganimete Terbeshi”Ponoshec 215 ditë x 2.00=430 euro,
4. Në Shkollën “Pjetër Muqaj” Guskë 215 ditë pune x2.00=430euro, gjithsejtë 813ditë x2.00=1,626.00euro.Pagesë sipas Vendimit të MPMS i është bërë në shumë 1,108.00 euro, të pa paguar për ushqim kanë mbetur 518.00 euro, për periudhën 01 shtator 2015 deri më 31 maj 2021.

Llogaritja e shpenzimeve të udhëtimit bazuar në vijueshmërinë e paditëses në punë në shkollat e lartë cekura dhe Vërtetimit të Shoqatës së Transportit të Udhëtarëve në lidhje me çmimet e biletave, shpenzimet e udhëtimit janë:

1. Gjakovë –Sheremt dy drejtime 176 ditë x2.60 -30%=320,32 euro
2. Gjakovë- Ramoc dy drejtime 207 ditë x1.40-30%=202,86 euro.
3. Gjakovë- Ponoshec dy drejtime 215ditë x2,60-30%=319.30 euro.
4. Gjakovë-Guskë dy drejtime 215 ditë x1,00 -30%=150,50euro, gjithsejtë shuma 992.48 euro, gjithsejtë shpenzime të ushqimit 518,00 euro dhe shpenzime të udhëtimit 992,48 euro gjithsejtë 1,510.48 euro.

Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar e nënshkruar në mes të SBASHK-ut dhe MASHT-it me datë 11 prill 2014, e cila për implikimet financiare ka filluar të zbatohet nga data 01 janar 2015 sipas nenit 36.8 përcakton se të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është së paku dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete.Punëdhënsi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim pagese ( dy ) euro të të punësuarve për ushqim. Paragrafi 6 i të njëjtit nen e rregullon çështjen e mësimdhënësve që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban, kontratë është e zbatueshme deri me datë 18 prill 201. Sipas Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovës që ka hyrë në fuqi nga data 18 prill 2017 dhe Kontratës së Re Kolektive të datës 22 janar 2021 është i zbatueshëm neni 35 paragrafi 5 që përcakton “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban. Neni 35 paragrafi 7 i të njëjtave Kontrata përcakton se “ Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2.00€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarave, përmes restoranteve a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

E paditura, paditëses ia ka kompensuar shpenzimet e ushqimit për ditët e pranisë në punë nga dy euro për 554 ditë të pranisë në punë në shumë prej 1,108.00 euro ( në procedurë administrative sipas Vendimit Nr. 1284/2020 të datës 05 nëntor 2020) ndërkaq ka mbetur pa ia paguar shumën prej 518.00 euro për 259 ditë, për periudhën deri më datën 31 maj 2021. Paditëses për periudhën nga data 01 shtator 2015 deri me datën 31 maj 2021 nuk i janë paguar shpenzimet e udhëtimit për dy drejtimet nga vendbanimi i saj Gjakova dhe anasjelltas për në shkollat ku ka punuar dhe udhëtuuar dhe atë Shkollën “ Dy Dëshmorët” Sheremet për 176 ditë të pranisë në punë në Gjakovë-Sheremet dhe anasjelltas 176x 2.60-30%=320.32 euro, për

Shkollën “Ardhëmria” Ramoc për 207 ditë të pranisë  $207 \times 1.40 - 30\% = 202,86$  euro, për Shkollën “Ganimete Terbeshi” Ponoshec për 215 ditë të pranisë në punë  $215 \times 2.60 - 30\% = 319.30$  euro dhe për Shkollën në Guskë “Pjetër Muqaj” për 215 ditë  $\times 1.00 - 30\% = 150.50$  euro, gjithsejtë shumën 992.48 euro.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysish edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. Sipas neneve të lartë cituara është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e ushqimit dhe të udhëtimit, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ato kontrata, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve.

Bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se “debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën e që lartësia e kamatë vonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Paditësit i takon kamata e kërkuar nga data e marrjes së këtij Aktgjykimi 10 mars 2022 për shkak të rënies në vonesë të paditurës për përmbushjen e detyrimit të saj sa i përket shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe TA ku paditësit i ka njohur të drejtën e shpenzimeve procedurale për taksë gjyqësore shumën 20.00 €, për përpilim të padisë shumën 104.00€, për përfaqësim në një seancë 135.20€, për përpilim të ekspertizës financiare shumën 100.00 euro, gjithsejtë shumën 359.20 euro.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
C.nr. 1011/21, datë 19 prill 2022

Gj y q t a r j a,  
Afijete Sada Gillogjani

**UDHËZIM JURIDIK;** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.